



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

RREGULLORE

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË I.L.D.K.P.K.I

Tiranë, Shtator 2014

KREUI

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në ILDKPKI, bazohet në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

Neni 2

Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në ILDKPKI.
2. Eprorët e zyrtarëve në ILDKPKI, sipas hierarkisë, brenda institucionit të ILDKPKI-së janë: Inspektori i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, Inspektorët, Drejtori i Kabinetit, Autoriteti Përgjegjës - Drejtori i Drejtorisë të Financave dhe Administrimit, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Institucionet, Drejtori i Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik dhe Konfliktit të Interesit, Përgjegjësit e seksioneve.
3. "Institucion epror" për ILDKPKI-në është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Roli "epror" ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucionit të pavarur ILDKPKI.
4. "Person i lidhur me një zyrtar të ILDKPKI-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
5. "Parim i proporcionalitetit" (sipas nenit 46 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari të ILDKPKI-së me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetiake.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. çdo zyrtar i ILDKPKI-së, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
2. çdo zyrtar i ILDKPKI-së, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. çdo zyrtar i ILDKPKI-së kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
4. personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 4

Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i) hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
 - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
 - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
 - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
 - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve

- nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
- vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së ILDKPKI-së.

Neni 5

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i ILDKPKI-së ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe ose ish-subjektet e ILDKPKI-së, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike qeveritare dhe administrimin financiar;
 - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të ILDKPKI-së:
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i ILDKPKI-së, i emëruar si i tillë nga Inspektori i Përgjithshëm, si dhe nga zyrtarët-eprorë në ILDKPKI.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7 , pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005.

Neni 6

Interesat privatë

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh) marrëdhënie:
 - i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;
 - iii) etnike;
 - iv) fetare;
 - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

Neni 7

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i ILDPKKI, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1 e 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, që përgatit raportet për kontroll të plotë në verifikimin e deklaratave të interesave private periodike të subjekteve të ILDKPKI-së, që mbikqyrin ose përdorin fonde publike, që lidhin kontrata shërbimi, investimi, që përfaqësojnë ILDKPKI-në në marrëdhënie me të tretët, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga Sekretari i Përgjithshëm, Inspektorët dhe Ndihmës/Inspektorët, Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Administrimit, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Institucionet, Drejtori i Kontrollit Paraprak Aritmetik-Logjik dhe Konfliktit të Interesit, Drejtori i Kabinetit, Këshilltari i Inspektorit të Përgjithshëm, shefat e sektorëve dhe specialistët, kur kjo kërkohet nga Inspektori i Përgjithshëm.
3. Deklarimi rast për rast i interesave private të Inspektorit të Përgjithshëm bëhet çdo herë kur kjo kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
4. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave private në ILDKPKI.
6. Inspektori i Përgjithshëm, me mbështetjen e Drejtorisë së Financave dhe Administrimit dhe në bazë të vetdeklarimit të zyrtarit të ILDKPKI-së, si dhe në

bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash. Inspektori i Përgjithshëm merr masa që zyrtarit të mos t'i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash dhe në rast të kundërt mer masa për largimin e zyrtarit nga detyra.

Neni 8

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë .

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në ILDKPKI, është:
 - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijëni;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijëni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të ILDKPKI-së mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 9

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i ILDKPKI-së

1. ILDKPKI-ja vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, në formë e në përmbajtje, që këta duhet të lëshojnë.
2. Në rastin e Inspektorit të Përgjithshëm, autorizimi vihet në dispozicion, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji nga Inspektori i Përgjithshëm dhe nga Inspektorët e ILDKPKI është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në ILDKPKI janë:
 - a) Inspektori i Përgjithshëm;

- b) Sekretari i Përgjithshëm;
- c) Inspektorët dhe Ndihmës/Inspektorët;
- d) Drejtori i Kabinetit;
- e) Drejtori i Drejtorisë së Finances dhe Administrimit;
- f) Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Institucionet;
- g) Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik dhe Konfliktit të Interesit;
- h) Përgjegjësit e Seksioneve;

Neni 11

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës (Drejtori i Financës dhe Administrimit)

Autoriteti Përgjegjës i ILDKPKI-së, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të ILDKPKI-së;
- b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët e ILDKPKI-së, sipas nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- c) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- ç) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të ILDKPKI-së, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
 - i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) kryen me autorizim të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, verifikim të interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Inspektorin e Përgjithshëm;
- dh) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- i) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
- f) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Institucionet;

- i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin ILDKPKI-në në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit te zyrtarët përgjegjës;
 - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të ILDKPKI-së, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm;
 - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Inspektori i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
 - iv. marrin masa për të miratuar në rregulloret e brendshme të ILDKPKI-së, udhëzimet e orientimet e lëshuara nga Kuvendi i RSH-së, si dhe nga Inspektori i Përgjithshëm;
- g) mbështet Inspektorin e Përgjithshëm në kryerjen e deklaramit periodik të interesave nga zyrtarët e ILDKPKI-së;
 - gj) bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e ILDKPKI-së për çdo këshillë apo udhëzim të Kuvendit të RSH-së dhe ILDKPKI-së;
 - h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-së për zyrtarët e këtij institucioni;
 - i) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 12

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të ILDKPKI-së, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës (Drejtori i Financës dhe Administrimit), i ILDKPKI-së .

Neni 13

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti përgjegjës (Drejtori i Financës dhe Administrimit), për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të ILDKPKI-së, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprrorët, nga Kuvendi ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave privatë

Neni 14

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të ILDKP-së bëhet në përputhje të kërkesave të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e ILDKPKI-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarim të interesave private periodike janë:
 - a) Inspektori i Përgjithshëm;
 - b) Sekretari i Përgjithshëm
 - c) Inspektorët;
 - d) Ndihmësinpektorët;
 - e) Drejtori i Kabinetit ;
 - f) Këshilltari;
 - g) Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Institucionet;
 - h) Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit;
 - i) Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik dhe Konfliktit të Interesit.
3. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të ILDKPKI-së, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Çdo zyrtar i ILDKPKI-së, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar "Deklaratë pas largimit nga funksioni". Drejtorja e Financës dhe Administrimit, si dhe Sektori i Administrimit të Financë Buxhetit, nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t'i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 15

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e ILDKPKI-së, përfiton, mbrojtje të veçantë

administrative, si më poshtë:

- a) zyrtari i ILDKPKI-së, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues (qofte ky dhe subjekti i ILDKPKI-së), dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
 - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i ILDKPKI-së, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.
2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të ILDKPKI-së është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
- a) kur zyrtari i ILDKPKI-së, është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
 - c) kur vendimet e zyrtarit të ILDKPKI-së, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
 - d) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
 - e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i ILDKPKI-së të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga Inspektori i Përgjithshëm ose nga Kuvendi, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 16

Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së:
 - a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
 - b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
 - c) nuk mund të jetë anëtar i partive politike dhe nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre;
 - d) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

2. Inspektorët dhe Nd/inspektorët, Drejtori i Financës dhe Administrimit, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhëniet me Institucionet, Drejtori i Kontrollit Paraprak Aritmetik-Logjik dhe Konfliktit të Interesit, Drejtori i Kabinetit dhe Këshilltari:

- a) nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
- b) nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c) nuk mund të jene anëtar të partive politike dhe nuk mund të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre
- d) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të ILDKPKI-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;

Neni 17

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në ILDKPKI të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në ILDKPKI, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
 - a) "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
 - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
5. Në asnjë rast zyrtari i ILDKPKI-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 18

Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e ILDKPKI-së, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 16 e 17 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
 - a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e ILDKPKI-së, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e ILDKPKI-së dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

4. Personi i lidhur me zyrtarin e ILDKPKI-së, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të ILDKPKI-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:
- a) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

Neni 19

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/ punonjësit e ILDKPKI-së bëhen sipas kreut IV të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 20

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të ILDKPKI-së, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Rregullorja e mëparshme dhe aktet që lidhen me të shfuqizohen.